



Arhiv

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
Sektori i Sekretari-Arkivit

Model nr. 5

KARTELE SHOQERUESE E PRAKTIKES

Dergues Preraktuna Tier
19.07.2021

Nr. Prot. 733/1 Data

Shtikurtimi i lendes K-Elim përfundim

Per trajtim nga:	
(struktura te tjera te ngarkuara)	<u>A. Erizo fiko</u>
Me porosi:	<u>Erizo fiko</u>

Normal (7dite) Prioritet (3dite) Urgjent (brenda dites) Pa afat/per dijeni Tjeter _____ dite

Data 21.07.21 Nr. Prot. 4700/1

Nenshkrimi: (TITULLARI)

Marrne dorezim: _____

Kalon per trajtim (struktura): _____

Me porosine: _____

Nenshkrimi

Marrne dorezim: _____

Kalon per trajtim (struktura): _____

Me porosine: _____

Nenshkrimi

Marrne dorezim: _____

Kalon per trajtim Specialistit: _____

Me porosine: _____

Nenshkrimi

Trajtimi i materialit perfunduar me: _____

Trajtimi i materialit pranuar me: _____

Trajtimi i materialit miratuar me: _____

Trajtimi i materialit miratuar me: _____

Specialisti

Eprori ne shkalle hierarkike

Eprori ne shkalle hierarkike

Eprori ne shkalle hierarkike

Nr. 4700/1 prot
21.07.2021



REPUBLIKA E SHQIPERISË
PREFEKTI QARKU FIER

Nr. 733/1 Prot.

Fier, më 19.07 2021

Lënda: Kthim përgjigje për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve Nr. 42, 45, 46, 49 dhe 51 të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuara në mbledhjen e datës 30.06.2021.

Drejtuar: Znj. Majlinda BUFI
KRYETARE E BASHKISË ROSKOVEC

Z. Kadri HYSKA
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC

ROSKOVEC

Në përgjigje të shkresës Tuaj me Nr. prot 4700 datë 02.07.2021, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier me Nr. 733 prot. datë 12.07.2021, bazuar në Ligjin Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 8 shkronja "a" neni 16 si dhe në Ligjin Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" neni 3 pika 2, shqyrtuam ligjshmërinë e vendimeve me karakter normativ të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuara në mbledhjen datës 30.06.2021, shoqëruar me dokumentacionin plotësues për vendimet dhe procesverbalin e mbledhjes Nr.4699/1 Prot. datë 30.06.2021, si më poshtë:

Vendimi Nr. 42 datë 30.06.2021 i Këshillit Bashkiak Roskovec "Për disa shtesa në vendimin Nr.88 datë 02.12.2020 "Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2021" shoqëruar nga projekt-vendimi me Nr. prot. 4480 datë 23.06.2021, relacioni me Nr. 4480/1 datë 23.06.2021, është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar) neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 54 shkronja "f"; Ligjin Nr. 9632 datë 30/10/2006 "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar) neni 35 pika 1 dhe 2 si dhe në zbatim të Ligjit Nr. 68/2017 "Për finanecat e vetqeverisjes vendore" neni 14.

Vendimi Nr. 45 datë 30.06.2021 i Këshillit Bashkiak Roskovec "Për miratim dhe transferim fondesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2021" shoqëruar nga projekt-vendimi Nr. 4 datë 23.06.2021, relacioni me Nr. prot. 4479/3 datë 23.06.2021, është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar) neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 23, neni 54 shkronja "dh"; Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSHP" neni 44; Ligjin Nr. 68 datë 27.04.2017 "Për finanecat e vetëqeverisjes vendore" neni 45.

Vendimi Nr. 46 datë 30.06.2021 i Këshillit Bashkiak Roskovec "Për miratimin e Dokumentit të parë për Programin Buxhetor Afat-Mesëm 2022-2024 të Bashkisë Roskovec" shoqëruar nga

projekt-vendimi Nr. 5 datë 24.06.2021 dhe relacioni Nr. 4480/3 Prot datë 25.06.2021, është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) neni 8, neni 9 pika 1.1/b, neni 41; Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH” neni 32; Ligjin Nr. 68 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 6 shkronja “ç”, neni 36 pika 8 si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”.

Vendimi Nr. 49 datë 30.06.2021 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për miratimin e dokumentit të rishikimit të Planit të Përgjithshëm vendor të Bashkisë Roskovec” shoqëruar nga projekt-vendimi Nr. 9 datë 23.06.2021, relacioni me Nr. 4516/1 datë 24.06.2021, është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 54 shkronja “k” si dhe në zbatim të udhëzimit Nr.1 datë 22.02.2019 “Për Hartimin, Bashkërendimin, Miratimin dhe Kontrollin e Procesit të Rishikimit të Dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore me Procedurë të Thjeshtuar”, pika 2, 3 dhe shtojca 1, pika 5 shkronja “a”.

Vendimi Nr. 51 datë 30.06.2021 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për anulim të VKB-SË Nr. 38 datë 31.05.2021 “Për rishikimin e pjesshëm të dokumentit të planit të përgjithshëm vendor me procedurë të përshpejtuar, për Bashkinë Roskovec” shoqëruar nga projekt-vendimi Nr. 4610 datë 30.06.2021, relacioni me Nr. prot 4610/1 datë 30.06.2021, është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) neni 8, neni 9 pika 1.1/b si dhe në zbatim të Ligjit 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i RSH” neni 113.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

**PREFEKTI
Baki BALA**

